



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelaria Generalnog Sekretara/Office of the
General Secretary

Nr. 37/2022
Datë: 04/03/2022

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, nr. 7, 01 Mars 2019), duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 1) të Ligjit Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve si dhe në përputhje me nenin 5 dhe 6 të Rregullores QRK-Nr. 03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr:

V E N D I M

1. Znj. Albulena UKA, caktohet zyrtare përgjegjëse për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Obligohet zyrtarja e caktuar nga pika një (1) e këtij vendimi që rastet e sinjalizimit të paraqitura në Ministrinë e Drejtësisë t'i trajtojë në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, si dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi Nr. 21/2020, dt. 24.04.2020 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, me të cilin znj. Noliana Kusari është emëruar zyrtare përgjegjëse për trajtimin e rasteve të sinjalizimit në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj. Kusari për shkak të volumit të punëve në kuadër të Departamentit Ligjor ka ofruar dorëheqje nga pozita e zyrtares përgjegjëse për trajtimin e rasteve të sinjalizimit në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Andaj, me qëllim të përmbushjes së obligimit siç përcaktohet në nenin 17, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Znj. Albulena UKA, caktohet zyrtare përgjegjëse për trajtimin e rasteve të sinjalizimit në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Për arsyet e përmendura më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi i'u dërgohet:

- Znj. Albulena UKA
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Të gjithë personelit drejtues, profesional, mbështetës-administrativ dhe teknik të MD-së;
- Zv. Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror, avokatëve shtetëror dhe stafit të AVSH-së;
- Kryeinspektorit, inspektorëve, si dhe stafit të Inspektoratit të MD-së;
- Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të AAPSK-së dhe stafit të AAPSK-së;
- Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të IML-së dhe stafit të IML-së;
- Arkivit të MD-së.